



Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

Autoriteti i Konkurrencës i Republikës së Kosovës



Autoritet za Konkurenciju Republike Kosovo - The Competition Authority of the Republic of Kosovo

Vendimi nr. 57/22

Data: 20.12.2022.

Në bazë të nenit 34 paragrafi 12 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publik, të Neni 23 paragrafi 1 nënparagrafët 1.2 dhe 1.4 të Ligjit nr. 06/l -113 për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore dhe të agjencive të pavarura, të Neni 18 paragrafi 2 nënparagrafi 2.3 dhe Neni 20 paragrafi 2 të Rregullores (QRK) Nr. 16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil, Neni 30 paragrafi 2 nënparagrafi 2.1 të Ligjit Nr 08/L-056 për Mbrojten e Konkurrencës, Neni 14 paragrafi 1 të Statutit të Autoritetit të Konkurrencës së Republikës së Kosovës Nr 04 – V – 312 dhe Neni 9 paragrafi 1 të Rregullorës Nr 03 / 2018 për organizimin e brendshëm, sistematizimin e vendeve të punës dhe përshkrimin e detyrave të punës në Sekretariatit të Autoritetit të Konkurrencës së Republikës së Kosovës, në cilësinë e U.D. të Drejtorit të Përgjithshëm të Sekretariatit të Autoritetit të Konkurrencës së Republikës së Kosovës, nxjerrë këtë :

VENDIM

për emërimin e anëtarit të Komisionit të pranimit në cilësinë e ekspertit të jashtëm

1. z. Rifat Kelmendi , me numër personal: 1009739382 emërohet anëtar i Komisionit të pranimit në Autoritetin e Konkurrencës të Republikës së Kosovës, me mandat 2 (dy) vjeçar në cilësinë e ekspertit të jashtëm në fushën e përzgjedhjes / vlerësimit të burimeve njerëzore.
2. z. Rifat Kelmendi do të përfitoj një pagë fikse prej 250.00€ (dyqind e pesëdhjetë euro) për çdo procedurë në të cilën merr pjesë.
3. Obligohet Njësia e Burimeve Njerëzore që të ndërmerrë veprimet për zbatimin e këtij Vendimi.
4. Ky Vendim hynë në fuqi ditën e nënshkrimit nga U.D. Drejtori i Përgjithshëm i Sekretariatit të Autoritetit të Konkurrencës të Republikës së Kosovës.

Arsyetim

Autoriteti i Konkurrencës i Republikës së Kosovës duke u bazuar në legjislacionin në fuqi, përmes shpalljes publike të datës 07.11.2022, ka kërkuar ekspert të jashtëm në fushën e përzgjedhjes / vlerësimit të burimeve njerëzore, për ta emëruar anëtar të Komisionit të pranimit.

Në shpalljen publike kanë aplikuar disa kandidat dhe përcaktimi është për z. Rifat Kelmendi, i cili duke i plotësuar në tërësi kriteret e kërkuara emërohet anëtar i Komisionit të pranimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- Anëtarit të Komisionit të pranimit - ekspertit të jashtëm,
- Njësisë së burimeve njerëzore dhe
- Arkivës.

U.D. Drejtori i Përgjithshëm i Sekretariatit të
Autoritetit të Konkurrencës të Republikës së Kosovës



Selajdin Beqa
Selajdin Beqa